

---

**RAPORTI PERIODIK Nr. 1  
30 Maj–9 Qershor 2006**

**I. REZYME**

- Misioni për Mbikëqyrjen e Zgjedhjeve (MMZ) i Zyrës për Institucione Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut (ODIHR), hapi zyrën e saj më 30 Maj në Shkup, 20 monitorues afatgjatë janë shpërndarë në ekipe ndërkombëtare prej dy personash në 9 lokacione të ndryshme të vendit.
- Më 5 korrik, 120 deputetë do të zgjidhen në sistemin proporcional, nga njëzet deputetë në çdo njësi zgjedhore. Nuk ekziston ndonjë censur që duhet arritur për ndarjen e mandateve.
- 31 parti politike dhe koalicionet, dhe dy grupe votuesish, kanë dërguar listat me kandidatë për zgjedhje. Te gjitha listat zgjedhore u miratuan nga Komisioni Shtetëror Zgjedhor. Njëmbëdhjetë parti politike dhe koalicionet, do të garojnë në të gjashtë njësitë zgjedhore, dhe numri i kandidatëve për njësi zgjedhore është prej 19 deri 29. Një numër prej 2,920 kandidatëve do të garojnë në këto zgjedhje
- Disa bashkëbisedues kanë komentuar se lindja e partive të reja politike ka ndikuar në humbjen e përkrahjes për garuesit që në zgjedhjet e kaluara kanë qenë garues kryesorë, dhe ka mundësi që të krijojë pengesa pas- zgjedhore për përbërjen e koalicionit. Disa çështje janë ngritur si rezultat i vendimit të një partie politike shqiptare që në listën kandiduese të vendos një person ndaj të cilit janë ngritur dy padi penale dhe një person i cili është nën hetime për krime lufte.
- Fushata elektorale zyrtarisht do të fillojë me 15 qershor. Disa parti politike, janë akuzuar nga oponentët e tyre dhe nga përfaqësuesit shoqërisë civile, për nisjen e parakohshme të fushatës dhe shkeljen e Kodit zgjedhorë. KZSH, ka deklaruar se nuk kanë kompetenca për të iniciuar procedure për rastet në fjalë, dhe se Kodi zgjedhorë nuk parasheh dënime për fushatën e hershme.
- Në bazë të kornizës ligjore, mediumet janë të obliguara të ofrojnë kushte të njëjta për të gjithë kandidatët. Më 2 qershor, MMZ i ODIHR-it filloi të monitorojë mbulimi e fushatës nga mediumet duke përfshirë katër stacione televizive dhe një numër të madh të gazetave ditore.
- Kodi i ri zgjedhor u miratua në fund të muajit mars 2006, i cili ofron një bazë konzistente për mbajtjen e zgjedhjeve. Megjithatë, me sa duket ka nevojë për sqarime dhe qartësime në interpretimin e disa dispozitave. Qeveria, më 7 qershor i propozoi Kuvendit disa ndryshime, propozim – amendamentet kishin të bëjnë me ndryshimet në Kodin Penal, duke paraparë sanksione precize për veprat penale që kanë të bëjnë me Zgjedhjet.
- Zgjedhjet e ardhshme do të drejtohen nga administrata zgjedhore e përbërë prej tri niveleve, duke përfshirë KSHZ, 84 Komisione Zgjedhore Komunale dhe 2,976

Komisione Zgjedhore. KSHZ u emërua në muajin prill të këtij viti. Të gjithë anëtarët e Komisioneve Zgjedhore Komunale dhe shumica e anëtarëve të Komisioneve Zgjedhore, janë zgjedhur në mënyrë të rastit me tërheqje, nga ana e nëpunësve shtetëror, që ndryshon nga emërimet e mëparshme të bëra nga ana e partive politike.

## II. HYRJE

Kryetari i Kuvendit më 20 Prill, shpalli datën për Zgjedhjet Parlamentare në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, të cilat do të mbahen me 5 korrik 2006. Me ftesë të Ministrisë për Punë të Jashtme, Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) dhe OSBE, vendosën Misionin për Mbikëqyrjen e Zgjedhjeve (MMZ) më 30 Maj. Misioni kryesohet nga Ambasador Audrey Glover (nga Britania e Madhe), që përbëhet nga ekipi kryesorë prej 13 anëtarëve të stacionuar në Shkup, dhe 20 mbikëqyrës afatgjatë të vendosur në 9 lokacione të vendit. Anëtarët e ekipit dhe monitoruesit janë zgjedhur nga 21 shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së. Shteteve pjesëmarrëse u është kërkuar të dërgojnë edhe 250 mbikëqyrës afat shkurtër, për të mbikëqyrrur zgjedhjet, numërimin e tyre, dhe mbledhja e tyre.

## III. KORNIZA ZGJEDHORE

Anëtarët e Kuvendit (120) zgjidhen në bazë të sistemit proporcional, të ndarë në 6 njësi zgjedhore, të parapara në Kodin Zgjedhorë, në çdo njësi zgjedhore zgjidhen nga 20 anëtar të parlamentit. Nuk ekziston ndonjë nivel i daljes në votim (cenzus), me qëllim të ndarjes së mandateve.

Korniza ligjore për zgjedhjet e ardhshme parlamentare, është e rregulluar me Kodin Zgjedhorë, i cili është miratuar nga fundi i muajit mars 2006. Kodi i ri konsolidon legjislacionin zgjedhor dhe krijon një kornizë zgjedhore të përmirësuar. Edhe pse u finalizua vetëm tri muaj para zgjedhjeve, bashkë me amendamentet tjera ligjore, ajo ofron një bazë më konzistente për mbajtjen e zgjedhjeve. Mirëpo, disa bashkëbisedues çështjen e implementimit dhe interpretimit të Kodit Zgjedhorë, e vlerësojnë si diskutabile.

Në këtë drejtim, Komisioni Shtetëror Zgjedhor, ka rregulluar disa çështje në lidhje me procedurën zgjedhore, siç janë: të drejtat dhe detyrimet e mbikëqyrësve, balancimin e përbërjes së administratës zgjedhore dhe emërimin e tyre, trajnimet e zyrtarëve për zgjedhjet, aktivitetet policore, dhe hapjen e xhiro-llogarive për organizatorët e fushatës.

Edhe pse Kodi Zgjedhorë dhe aktet tjera ligjore janë të detajuara dhe precize, me sa duket ka nevojë për sqarime dhe qartësime në interpretimin e disa dispozitave. Për shembull, edhe pse proklamohet se fillimi i hershëm i fushatës shkel Kodin zgjedhorë, nuk janë paraparë ndëshkime, edhe KZSH ka deklaruar se nuk kanë kompetenca për të filluar procedure për rastet në fjalë.

Përveç kornizës zgjedhore të legjislacionit ekzistues, me 7 qershor Qeveria, i propozoi Kuvendit propozim-amendamentet për ndryshimin e Kodin penal, ndryshime këto të cilat parashikojnë sanksione precize për veprat penale që kanë të bëjnë me zgjedhjet. Kuvendi debatoi për amendamentet më 9 qershor. Disa nga partitë politike i përshëndetën këto ndryshime të propozuara në momentin e fundit, dhe vlerësojnë se vetëm me një vendosmëri për të zbatuar këto

ndryshime do të mund të ruhet procesi zgjedhor nga parregullsitë. Në zgjedhjet e më hershme vetëm disa persona janë dënuar për krime që kishin të bëjnë me zgjedhjet.

#### IV. ADMINISTRATA ZGJEDHORE

Kodi zgjedhorë parasheh një administratë zgjedhore të përbërë prej tri niveleve, që do të shërbejnë për të gjitha zgjedhjet, duke përfshirë Komisioni Shtetëror Zgjedhorë (KSHZ), 84 Komisione Zgjedhore Komunale, dhe 2,976 Këshilla Zgjedhore. Komisioni Shtetëror Zgjedhorë u emërua më 14 prill, nga ana e Kuvendit. Në pajtim me Kodin e ri zgjedhorë, partitë opozitare, në këtë rast, partia VMRO- DPMNE, propozoi kryetarin e KSHZ-së, ndërsa partia në pushtet propozon zëvendës kryetarin, në këtë rast, propozimi Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI), u pranua. Kodi zgjedhorë nuk parasheh se si zgjidhen anëtarët tjerë, nga praktika, ato zgjidhen nga ana e partive shumicë.

Për herë të parë, anëtarët e Komisioneve Zgjedhore Komunale dhe Komisioneve Zgjedhore janë zgjedhor në mënyre të rastit me tërheqje, nga ana e nëpunësve shtetëror, që ndryshon nga emërimet e mëparshme të bëra nga ana e partive politike<sup>1</sup>. Çdo Komision Zgjedhor Komunal përbëhet nga pesë anëtarë dhe pesë nën-kryetarët. Kryetarët dhe nënkryetarët zgjidhen nga ana e administratës shtetërore dhe komunale, kurse anëtarët tjerë zgjidhen nga ana e zyrtarëve të administratës publike. Me rastin e emërimit të tyre, duhet të respektohet parimi i përfaqësimit gjinor dhe etnik.

Fillimisht përzgjedhja e kandidatëve u bë në kohë, mirëpo duheshin bërë edhe disa zgjedhje të reja të anëtarëve tjerë të Komisionit Zgjedhor Komunal dhe Këshillave Zgjedhore, me qëllim të zëvendësimit të anëtarëve që kishin dhënë dorëheqje për shkak se ishin të regjistruar si kandidatë. Të gjithë anëtarët e Komisioneve Zgjedhore Komunale kanë marrë pjesë në trajnime të detyrueshme. Afërsisht 3,000 nëpunës do të shërbejnë larg shtëpive të tyre gjatë ditës së zgjedhjeve, dhe për momentin KSHZ, është duke diskutuar mundësitë për sigurimin e transportit, me qëllim që ata të votojnë po atë ditë.

Që nga momenti i ardhjes së Misionit për Mbikëqyrjen e Zgjedhjeve (OSCE/ODIHR), KSHZ ka mbajtur tetë mbledhje të cilat ishin të hapura për mediat dhe monitoruesit e ODIHR kanë marrë pjesë në këto mbledhje. KSHZ ka miratuar instruksionet, rregullat dhe formularët të parapara sipas Kodit Zgjedhorë dhe ka dhënë disa sqarime në lidhje me aplikimin e dispozitave konkrete.

Pas skadimit të afatit ligjor për ndryshime dhe plotësimin e listës zgjedhore, Ministria e Drejtësisë i mbylli listat votuese për ndryshim. Me 9 qershor të gjitha ekstraktet nga listat votuese të cilat përbënin një numër prej 1,741,449 votues, i dorëzoi deri tek KSHZ për aprovim dhe nënshkrim. Disa bashkëbisedues nga partitë politike shprehën dyshimet në lidhje me saktësinë e listës votuese.

#### V. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Më dy qershor KSHZ përfundoi regjistrimin për listatat e kandidatëve. Partitë politike (31) dhe koalicionet e ndryshme, si dhe dy grupe nismëtare, kanë dërguar listat me kandidatë për zgjedhjet, duke kandiduar kandidatë për një ose më shumë njësi zgjedhore. Të gjitha listat zgjedhore u miratuan nga Komisioni Shtetëror Zgjedhor në një proces të brendshëm. Një numër

---

<sup>1</sup> Si masë kalimtare për vetëm për këto zgjedhje, nga dy anëtar të çdo Komisioni Zgjedhor dhe zëvendësimit të tyre ishin të emëruar nga partitë politike, një anëtar nga partitë opozitare dhe një nga partitë në pushtet.

prej 135 listave me 2,920 kandidatëve, janë regjistruar në gjashtë njësi zgjedhore. Njëmbëdhjetë parti dhe koalicione kanë dorëzuar lista për çdo njësi zgjedhore. Numri i kandidatëve për njësi zgjedhore është prej 19 deri 29.

Komisioni Shtetëror Zgjedhor më 7 qershor organizoi tërheqjen e shortit, që përcaktoi renditjen e kandidatëve në fletëvotim, në çdo njësi zgjedhore. Sipas Kodit zgjedhorë, së paku një nga tri vendet në listat zgjedhore duhet rezervuar për gjininë më pak të përfaqësuar.

## VI. ATMOSFERA PARAZGJEDHORE

Zgjedhjet parlamentare duheshë të mbahet në tetor të vitit 2006. Partia udhëheqëse opozitare, VMRO- DPMNE, disa herë kërkoi që zgjedhjet të mbahen më herët, dhe në fillim të 2006 partia në pushtet Lidhja Social –Demokrate e Maqedonisë (LSDM), ishte në favor të mbajtjes së zgjedhjeve të mëhershme.

Politika është e ndarë në linja etnike, sikurse edhe në zgjedhjet e kaluara, garat do të zhvillohen në mes partive etnike të cilat do të garojnë për votat e komuniteteve të tyre. Koalicioni “Për Maqedoninë së Bashku” i udhëhequr nga LSDM do të ballafaqohet me VMRO-DPMNE që ka themeluar koalicion me partitë më të vogla në vend. Partitë politike shqiptare pjesëmarrëse në parlament, Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI-së), partner i koalicionit qeveritar me LSDM-në, dhe partia opozitare Partia Demokratike Shqiptare (PDSH-së) janë garuesit kryesorë për votat e shqiptarëve etnik.

Shumë parti të reja politike janë themeluar. Duke përfshirë këtu VMRO – Partia Popullore (VMRO–NP), e cila është ndarë nga VMRO–DPMNE në fund të vitit 2004. VMRO–NP edhe pse kishte më shumë deputetë, në Zgjedhjet lokale të vitit 2005 nuk tregoi ndonjë rezultat të rëndësishëm. Partia e Re Sociale Demokrate (NSDP) u themelua në tetor të vitit 2005, nga ana e Tito Petkovskit ish zyrtari i vjetër i LSDM-së, dhe ka arritur të formojë një rrjet të degëve në vend. Partia “Ripërtrirja Demokratike e Maqedonisë, u formua në janar të 2006 nga Liljana Popovska, ish zyrtare në Partinë Liberal Demokrate (LDP), partner i koalicionit qeveritar me LSDM-në. Disa bashkëbisedues kanë komentuar se lindja e partive të reja politike ka ndikuar në humbjen e përkrahjes për garuesit që në zgjedhjet e kaluara kanë qenë garues kryesorë, dhe ka potencial që të krijojë pengesa pas-zgjedhore për përbërjen e koalicionit.

Disa çështje janë ngritur, në lidhje me vendimin e PDSH-së për të kandiduar dy kandidatë, nga të cilët, ndaj njërit janë ngritur dy padi penale, kurse tjetri është nën hetime për krime lufte .

Fushata zgjedhore zyrtarisht fillon më 15 qershor. Fillimi i hershem i fushatës nga disa parti politike, që është në kundërshtim me Kodin zgjedhorë, ka bërë që disa medime dhe organizata jo qeveritare, të ketë akuza ndërmjet partive të ndryshme. Aktivitete të tilla kishin të bënin me mbajtjen e konventave partiake, të cilat për qëllim kishin të promovojnë kandidatët dhe programet e tyre partiake para medimeve. Disa aktivitete grindëse kanë të bëjnë me vendosjen e posterëve nëpër bilborde, dhe vizitat e ndryshme në vend nga ana e partive politike. Ka pasur kundërtënie në lidhje me atë se cilat aktivitete kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore e cilat konsiderohen si aktivitete të rregullta partiake.

## VII. MEDIUMET

Votuesit kanë qasje në burime të ndryshme të informatave. Ekziston një numër i madh i shtëpive transmetuese të regjistruara (153), si dhe një numër i madh i mediave shtypura në gjuhën maqedonase dhe gjuhët e komuniteteve që jetojnë në Maqedoni.

Mbulimi medial i fushatës së zgjedhjeve parlamentare është i rregulluar me Kodin zgjedhorë. Gjate periudhës zyrtare të fushatës zgjedhore, transmetuesit duhet të respektojnë rregullat që kanë të bëjnë me prezantimin e barabartë të pjesëmarrësve në zgjedhje. Ata po ashtu duhet të respektojnë dispozitat e Ligjit mbi Aktivitetet Transmetuese. Si parim i përgjithshëm, në bazë të kornizës ligjore, mediumet duhet të ofrojnë kushte dhe qasje të njëjta për të gjithë pjesëmarrësit në zgjedhje.

Rregullat për prezantim të barabartë medial, u miratuan nga Kuvendi më 22 maj, me propozim të Këshillit për Radiodifuzion, që kanë të bëjnë me mediumet shtetërore dhe private. Në bazë të këtyre rregullave, Radio Televizioni i Maqedonisë (RTVM) do të ofrojë mundësinë e promovimit të gjithë kandidatëve të regjistruar në emisionet e tyre, pa pagesë.

Transmetuesit në nivel shtetëror, si ato publik dhe privat, në programin e tyre duhet të sigurojnë një mbulim të balancuar medial për të gjithë pjesëmarrësit një zgjedhje, në pajtim me parimin e proporcionalitetit, duke u bazuar në numrit e listave të kandidatëve për çdo njësi zgjedhore. Transmetuesit lokal duhet të ofrojnë një mbulim të barabartë, bazuar në numrin e listave të kandidatëve për çdo njësi zgjedhore në zonën në të cilën ka fituar koncesion.

Transmetuesit privat duhet të sigurojnë kushte të njëjta për programet e paguara politike, dhe për këtë lloj të reklamimit ekzistojnë kufizimet. Përfaqësuesit e partisë VMRO–DPMNE publikisht e shprehën pakënaqësinë e tyre për kufizimet e parapara, duke deklaruar se kufizimet e parapara nga Këshilli për Radiodifuzion, nuk u mundësojnë partive politike që të bëjnë një prezantim adekuat të programeve të tyre.

Misioni për Mbikëqyrjen e Zgjedhjeve OSBE/ODIHR ka bërë analiza kualitative dhe kuantitative të disa medimeve që nga 2 qershori, me qëllim të vlerësimit të mbulimit medial të kandidatëve të partive kryesore politike. Aktivitetet monitoruese përqendrohen në kohën e imitimit të programeve në terminët më kryesore në katër kanale në nivel shtetëror edhe atë: kanali i parë TVM-së, dhe tri kanalet private (TVA1, TV Sitel dhe Kanal5), si dhe një numër të gazetave ditore në maqedonisht dhe në gjuhën shqipe. Përveç kësaj, Misioni për Mbikëqyrjen e Zgjedhjeve OSBE/ODIHR, po ashtu monitoron edhe lajmet kryesore në gjuhën shqipe në kanalin publik të TVM2 si dhe ndarjen e vendeve pa pagesë për prezantim në kanalin e tretë të TVM-së (MTV+).

Rezultatet pre-elimare të MMZ (OSBE/ODIHR) për monitorimin e medimeve, tregojnë se mediumet kanë raportuar mbi aktivitetet për përgatitjen e fushatës, duke përfshirë konferencat për shtyp dhe prezantimin e kandidatëve. Raportet për premtimet e partive politike që kanë të bëjnë më fushatën, si dhe komenteve ndërpartiake në lidhje me platformat politike po ashtu janë pjesë e agjendës së medimeve para fillimit zyrtarë të fushatës. Programet e paguara politike tani më kanë filluar të emitohen.

## VIII. AKTIVITETET E MISIONIT PËR MBIKQYRJEN E ZGJEDHJEVE (MMZ)

Misioni për Mbikëqyrjen e Zgjedhjeve (OSBE/ODIHR) hapi zyrën e saj në Shkup më 30 maj. Shefi i misionit, më 31 maj, mbajti një konferencë për shtyp për të prezantuar misionin. Shefi i misionit ka pasur disa takime fillestare dhe ka themeluar kontakte të rregullta me Ministrinë e Punëve të Jashtme, Komisionin Shtetëror Zgjedhor, përfaqësuesit diplomatik, partitë politike kryesore në vend dhe shoqërinë civile, duke përfshirë edhe organizatën e cila bën mbikëqyrjen e zgjedhjeve MOST. Anëtarët kryesorë dhe monitoruesit afatgjatë kanë mbajtur takimet fillestare me komisionet zgjedhore, partitë politike, shoqërinë civile dhe mediat në nivel shtetëror dhe regjional.

*Ky raport është i mundshëm në gjuhën angleze, maqedonase dhe shqipe.  
Megjithatë, versioni në gjuhën angleze është i vetmi version zyrtar.*